

Të rinjtë dhe FJALA E LIRË



Deklarata Universale e të drejtave të njeriut

Neni 19.
Gjithkush e ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë e përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje të të tjerëve, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe shpërndarjes të informacionit dhe ideve përmes çfarëdo mjetei mediatic, pa marrë parasysh kufizimet.

Liria e fjalës si fjalë e lirë



Atifete JAHJAGA

Presidente e Republikës së Kosovës

Secili njeri e ka të drejtën e patjetërsueshme të shprehet e të flasë lirshëm. Liria e fjalës, si liri e shprehjes, si mendim, i thënë lirshëm dhe i bërë publik, është ndër vlerat themelore që e dallon qartë shoqërinë demokratike. E vërteta, e thënë me kohë dhe e thënë troç, përbën lajmin. E lajmi ka për qëllim informimin, që i bëhet i njohur publikut i cili krijon opinionin duke pasur

për këtë edhe qëndrimin çfarëdo qoftë ai. Pak a shumë, kjo është shprehja e lirë, kjo është liria e fjalës, që nuk ka të bëjë vetëm me mediet por që përfshin të gjithë spektrin e shoqërisë. Liria e shprehjes si bazë e demokracisë është vetëdija kritike për të gjitha gjërat që na rrethojnë e për të cilat komunikojmë. Kjo është e drejta themelore e njeriut, një nga pararendëset e të drejtave dhe e lirisë të tjera qytetare. Republika e Kosovës si një shoqëri në tranzicion është vlerësuar mirë për lirinë e shprehjes, është vlerësuar për mediet e pavarura dhe profesionale, që ka ndikuar pozitivisht në të gjitha proceset zhvillimore demokratike të vendit tonë edhe pse në këtë lëmi drejt mediave e gazetareve profesionist e të

pavarur duhet punuar ende. Një fushë e veçantë është normimi i kësaj lëmie në të cilën gjithsesi ndikon tradita, zhvillimi i përgjithshëm, kushtet specifike të vendit por veçanërisht synimet tona, ndërlihdhet dhe ndërthurjet me trendet bashkëkohore, dhe sidomos me praktikën dhe me përvojat e Bashkimit Europian ku si popull dhe si shtet mëtojmë të anëtarsohemi si pjesë e barabartë dhe dinjitoze. Normimi nëpërmjet rregullativës ligjore në vendet demokratike gjithsesi e ka për qëllim që të sigurojë dhe të ofrojë të gjitha kushtet për një gazetari të mirëfilltë dhe hulumtuuese, duke pasur një trajtim më specifik për këtë profesion dhe për këtë mision në shërbim të vërtetës duke informuar saktë, drejtë dhe me kohë. Shoqëria u mundëson

gazetarëve qasje të papenguar në të gjitha burimet për kryerjen e profesionit si dhe mbrojtje të nevojshme të të dhënave dhe të burimeve të informacionit. "Lajmësi nuk ndiqet" është parim i kodit të lashtë, që siguron shpërndarjen e informacionit dhe dhënien e lajmit pa marrë parasysh çfarë lajmi është ai për marrësin. Gazetarët e kanë mekanizmin rregullues të punës së vet, të kodit të etikës, të sjelljes, të profesionit, respektimi i të cilit i ka bërë që ata të jenë të nderuar për përkushtimin dhe për punën e tyre. Duke qenë gazetari i lirë dhe i papenguar në ushtrimin e profesionit atëherë është gazetaria e mirëfilltë, e pavarur dhe e paanshme që konsiderohet kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e demokracisë së një vendi.

Normimi ligjor i lëmisë së informimit i të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces gjithsesi e ka për qëllim garantimin e shprehjes së lirë, që të papenguar gazetaret të kryejnë punën e vet të ndihmuar në dhënien e selektimit informatave. Vendi ynë ka nevojë për gazetari të angazhuar dhe profesionale, të lirë ta thotë të vërtetën kudo, kurdo dhe ndaj gjithsecilit. Kosova si një demokraci e re duke përfaqëuar praktikën dhe traditën më të mirë të vendeve të demokracisë europiane ku gazetaret dhe gazetarët janë hallkë shumë e rëndësishme e përparimit të proceseve demokratike dhe e respektimit të plotë të lirisë dhe të drejtave të njeriut bëhet një shembull i tranzicionit të suksesshëm duke qenë të gjithë kontribuues të kësaj.

Dita e zërave të rinj

Të rinjtë kanë qenë gjithmonë zëri më i fuqishëm i shprehjes së lirë, dhe jam e lumtur që Universiteti i Prishtinës dhe gazetaret Epoka e Re dhe Zëri kanë bashkëpunuar me të rinjtë për ta përgatitur këtë material që i dedikohet rinisë, por që besoj se do të jetë interesant për të gjitha gjeneratat. 3 maji, dita e lirisë të shtypit, është një ditë e përqendruar posaçërisht tek gazetaret, të cilët me shumë mund përpigën që të na ndihmojnë ta kuptojmë të vërtetën, ose të paktën të na e përafrojnë të vërtetën, dhe na ndihmojnë të krijojmë pikëpamje të fuqishme - duke e rrezikuar kështu shpesh jetën e tyre për t'i arritur këto synime. Kjo shtojcë është meritë e studentëve të udhëhequr nga profesor Lindita Tahiri.



Ne si Shoqata Botërore e Gazetave dhe e Botuesve të Lajmeve (WAN-IFRA) i përgëzojmë për trajtimin tejet kreativ të çështjeve jashtëzakonisht të rëndësishme.

Në vitin 1948 shoqatën tonë e themeluan ata të cilët e kishin mbajtur shtypin ilegal në Francë dhe në Holandë, duke i mbijetuar vitet e kundërvënies ndaj regjimit nazist. Që nga ajo kohë ne përpigëmi t'ua bëjmë të qartë qeverive, gazetave, dhe lexuesve se pa shtypin e lirë, shoqëritë tona demokratike e humbasin thelbin e kuptimit të tyre dhe nuk e meritojnë më të quhen vende demokratike. Liria për t'i kritikuar dhe për të kërkuar llogari nga ata që janë në pushtet është e drejtë që e gëzon shtypi i lirë - e drejtë që vetëkuptohet nga ekzistenca e shtypit - e drejtë e cila ushtrohet çdo ditë, në

3 maji është një datë në të cilën festohen parimet themelore të lirisë së shtypit, një ditë për të vlerësuar lirinë e shtypit nëpër botë, për të mbrojtur mediat nga sulmet mbi pavarësinë e tyre dhe për të nderuar gazetaret që kanë humbur jetën gjatë ushtrimit të profesionit.



Kjo datë u shpall si "Dita Botërore e Lirisë së Shtypit" nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1993, pas një rekomandimi të miratuar në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s, në vitin 1991.

çdo cep të globit. Dhe, gazetaret inteligjente, siç është kjo të cilën e keni në duar, përkujdesen që lexuesit e tyre të jenë pjesë e rëndësishme e debatit për këtë të drejtë, e sidomos kur bëhet fjalë për lexuesit që i takojnë gjeneratës të ardhshme.

WAN-IFRA është Shoqata Botërore e Gazetave dhe Botuesve të Lajmeve, me seli në Paris dhe në Darmstadt. Ajo përfaqëson 18 000 botime, 15 000 botime në ueb, dhe 3 000 kompani në 120 shtete. Misionet tona kryesore janë: mbrojtja e lirisë të shtypit dhe zhvillimi i një gjenerate të ardhshme të shkolluar dhe me vetëdije të ngritur qytetare, që do të mundësonte ardhmërinë e një shtypi të suksesshëm. WAN-IFRA përfshin 72 shoqata të gazetave dhe mediave në mbarë botën dhe i ka degët e veta në Indi, Spanjë, Francë, Singapor dhe në Suedi.

Dr. Aralynn MCMANE
Drejtor Ekzekutiv
Zhvillimi i Lexuesve të Rinj
Shoqata Botërore e Gazetave
dhe Botuesve të Lajmeve
(WAN-IFRA), Paris

E dimë se liria e shprehjes është element thelbësor i demokracisë, dhe këtë liri e gëzojnë të gjithë. Të gjithë kanë të drejtë ta shprehin lirshëm mendimin e vet, por edhe kanë të drejtë të vendosin të mos e shprehin. Të gjithë kanë të drejtë të kërkojnë, të marrin dhe të shpërndajnë informacione nga mediat, ashtu siç e thotë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

Liria e të shprehurit nuk është vetëm një e drejtë universale, por është edhe një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e personalitetit, për zhvillimin e dijes dhe për pjesëmarrjen në proceset vendim-marrëse.

Prandaj të rinjtë duhet të pajisen me shkathtësitë dhe mekanizmat që u mundësojnë ta shfrytëzojnë lirinë e shprehjes, në mënyrë që të jenë qytetarë të përgjegjshëm të një shoqërie demokratike dhe të jenë pjesë e një shoqërie të arsimuar të informacionit, jo vetëm duke identifikuar dhe duke shfrytëzuar informata, por edhe duke i prodhuar ato.

Cilat janë kushtet që e mundësojnë fjalën e lirë?

Në cilat kushte rrezikohet fjala e lirë?

A mendon se ti e gëzon lirinë e shprehjes?

Kur ka qenë hera e fundit që e ke përjetuar dhe e ke shfrytëzuar këtë liri? Jep shembuj!




FALENDEROJMË WAN-IFRA - SHOQATËN BOTËRORE TË GAZETAVE DHE BOTUESVE TË LAJMEVE QË NA LEJOI SHFRYTËZIMIN E ILUSTRIMIT.

Çka do të kishte ndodhur po të mos kishin folur ata?



Martin Luther King Jr. (1929-1968). Aktivist i shquar për të drejtat civile të njerëzve me ngjyrë në ShBA. Në kohën kur njerëzit me ngjyrë ishin të ndarë nga të bardhët në çdo fushë të jetës, ai dha një porosi të fuqishme e cila u bë realitet: "Unë kam një ëndërr...".




Fan S. Noli (1882-1965). Burrështetas shqiptar, diplomat në OKB dhe ShBA, shkrimtar i madh dhe poet i mirënjohur, dramaturg dhe përkthyes i Shakespeare-t dhe Goethe-s, muzikant dhe studiues i Beethoven-it. Ishte paqësor në bindje politike, por mbretin Zog e rrëzoi me revolucion.



Sevasti Qiriazi (1871-1949). Themeluese e shkollës së parë shqipe të femrave në Korçë më 1891. Pjesëmarrëse në Kongresin e Manastirit. Ajo botoi disa gramatika të gjuhës shqipe dhe përpiloi tekste mësimore për shkollat e reja shqipe që po hapeshin në fillim të shek. XX.



Parashqevi Qiriazi (1880-1970). Botuesja e parë femër e abetares në gjuhën shqipe. Bashkëthemeluese e shoqatës "Ylli i Mëngjesit" në ShBA. Ishte aktive në mbrojtjen e pavarësisë dhe të drejtave të kombit shqiptar nëpër gazeta dhe revista të ndryshme amerikane. Në Konferencën e Paqes në Paris më 1919 përfaqësonte zyrtarisht komunitetin shqiptar në ShBA.



Ismail Kadare (1936-) Shkrimtari më i njohur shqiptar, i nominuar disa herë për çmimin Nobel, i shpërblyer me mirënjohje si: "The Man Booker International Prize", çmimi më prestigjioz në botën anglishtfolëse, "Princi i Asturias për Letërsinë", çmimi i madh letrar spanjoll. Arriti të ushqejë lirinë e mendimit dhe fuqinë e imagjinatës në një ndër regjimet më totalitare në historinë e njerëzimit, dhe vazhdon ta bëjë po të njëjtën gjë, në rrethana të reja.

SI VJEN LIRIA?



Çka simbolizon për ty Gjergj Kastrioti Skënderbeu?

Çka simbolizon për ty Kuvendi i Arbrit i mbajtur në 2 mars të vitit 1444 në Lezhë dhe Besëlidhja Arbërore në krye me Skënderbeun?

Çfarë kupton me fjalët e Skënderbeut: "Lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta këtu, në mesin tuaj"?


Media dhe liria e shprehjes
Si lidhet fjala e lirë me mediat e lira?
Cili është roli i gazetarit për lirinë e shprehjes?

Mendo për shtypin e lirë në Kosovë: a janë gazetatat private apo të shtetit, cilët janë pronarët e tyre, a janë fytyra politike, a janë të lirë apo kanë presione politike, a kanë interesa të veta dhe e përputhen ato me interesat e tua? Jep shembuj!

Bota e informacioneve



Jetojmë në një botë përplot informacione, të cilat shtohen me shpejtësi marramendëse. Për shembull, deri në vitin 2009, gjatë gjithë historisë moderne botërore, janë botuar 130 milion libra. Ta zëmë se dëshirojmë t'i lexojmë këto libra, atëherë po e bëjmë një plan: leximin duhet ta fillojmë në moshën 5-vjeçare, dhe të lexojmë 70 libra gjatë çdo sekonde, secilën ditë, deri sa të mbushim 65 vjeç, pa bërë asnjë pauzë ndërmjet leximeve. Mirëpo, kur ta kemi mbaruar leximin, kushedi sa libra të tjerë do të



jenë botuar: sot, botohen rreth 1500 libra në ditë në mbarë botën. Radiostacionet transmetojnë 65.5 milionë orë të programeve origjinale çdo vit dhe televizionet transmetojnë 48 milionë orë të tjera. Dhe, nëse i marrim parasysh mediat e reja: në vitin 2011 vëllimi i World Wide Web ka arritur në 35 miliard faqe të



indeksuara. Në botë ka rreth 2 miliard shfrytëzues të internetit (rreth një e treta e popullsisë në botë), dhe ata marrin e dërgojnë 300 miliardë mesazhe elektronike çdo ditë. Nga momenti kur keni lindur, janë prodhuar më shumë informata se sa tërësia e informacioneve e prodhuar gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Është mahnitës i gjithë ky numër i të dhënave që na vërshon nga të gjitha anët, çdo ditë. Sot nuk është problem gjetja e informacioneve,

ashtu si për prindërit tuaj, por është problem organizimi dhe përzgjedhja e tyre në gjithë këtë rrëmujë. Si duhet t'u përfaqëmi gazetave, televizionit, reklamave, radios, muzikës, revistave, video-lojërave, librave të popullarizuar, mesazheve në internet dhe në facebook? Si t'i shfrytëzojmë ato, pa i lejuar të na shfrytëzojnë neve, qoftë duke na e marrë kohën, apo duke na bindur me porosi të cilat nuk janë të dobishme për ne? Me siguri shumica prej jush përdor njëherësh disa forma të mediave, p.sh përdorisa shkruani në facebook, njëkohësisht dëgjoni muzikë, dhe



shihni video në you tube apo porosi dhe reklama të cilat vazhdimisht ju dalin në ekran në faqet e internetit. Këto janë gjëra shumë të rëndësishme në jetën tuaj, sepse ju lidheni me shoqërinë dhe merreni vesh shumë lehtë

me njëri tjetrin kur flisni përmes hapësirës së internetit. Gjithashtu, kur ju bëni shumë gjëra njëkohësisht në internet, mund të ndodhë që në dhomë të jetë lëshuar edhe TV-ja, që e lëshoni mekanikisht sapo hyni në



dhomë, dhe prej nga dëgjohet ndonjë program apo reklamat. A keni menduar ndonjëherë se si arrini t'i pranoni të gjitha këto mesazhe, apo thjesht ju i dëgjoni dhe i lexoni ato automatikisht, duke e programuar veten si një kompjuter, që e ka për shprehje të



marrë shumë informacione të formave të ndryshme në të njëjtën kohë?

Nëse vërtet është kështu, a keni menduar ndonjëherë se kush e bën këtë programim: a e bëni ju vetë, a e bëjnë prindit, shkolla, shoqëria, reklamat, apo diçka tjetër? Si dallohet bota e juaj e vërtetë nga bota që e prodhojnë mediat?

Të provojmë ta kuptojmë këtë shprehje të programimit të mendjes sonë nga rrjedha e vazhdueshme dhe e pandalshme e mediave. Të provojmë ta kuptojmë se sa janë të dobishme për ne porositë që i kanë planifikuar mediat për ne. Të provojmë të kuptojmë se si mund ta sfidojmë atë që na e transmeton media si të vërtetë.

Sepse, mbi të gjitha, individin e veçon mendimi dhe fjala e lirë.

A mund të keqpërdoret liria e shtypit?

Gjuhëtari me renome botërore Van Dijk ka prezantuar një studim në një sesion shkencor të organizuar nga Komisioni European kundër Racizmit dhe Mostolerancës ku paraqiten marrëdhëniet mes diskursit publik dhe racizmit. Në këtë sesion, shumica e pjesëmarrësve ishin të shqetësuar më tepër për moskufizimin e lirisë së shtypit, ndërkaq, vetë Van Dijk i referohet lirisë së shtypit si "lopë e shenjtë" e elitave simbolike që në mënyrë të drejtpërdrejtë kërcënon interesat themelore të qytetarëve.

Nga një analizë e gjatë e shtypit europian Van Dijk-u përfundon se shtypi ashtu sikurse edhe institucionet elitare në Evropë, kontribuojnë në mënyra të veçanta në riprodhimin e racizmit në shoqëri. Ai thotë se në shoqëritë demokratike, institucionet e fuqishme duhet të jenë përgjegjëse për veprimet e tyre dhe meqë liria e plotë nënkupton fuqinë absolute, ajo duhet të kufizohet me ligje dhe me përgjegjësi morale e profesionale. Abuzimi i lirisë nga institucionet e fuqishme nënkupton abuzimin me pushtetin. Kjo vlen edhe për lirinë e të shprehurit dhe shtypit, thotë Van Dijk.

Çka mendon ti, si dallohet liria e shprehjes prej keqpërdorimit të lirisë të shprehjes?



Bëhu kontraverz!

Çfarë do të thotë fjala "kontraverz"?

Ka disa çështje që janë kontraverze. Kjo do të thotë se lidhur me këto çështje ekzistojnë mendime të ndryshme dhe për to nuk pajtohen të gjithë. Çështja kontraverze për disa njerëz është gjithnjë e hapur për debat, por disa të tjerë mendojnë se për të nuk duhet diskutuar aspak. Në disa vende të botës mund të shkruash lirisht për këto gjëra, por në disa të tjera, nuk e ke këtë të drejtë.

Në disa vende, gazetarët të cilat shkruajnë për çështje që qeveria i sheh si kontraverze, mund të ndodhë që të ballafaqohen me burg apo vdekje, dhe për të shpëtuar ata duhet ta braktisin vendin e vet. Në disa vende të tjera, thjesht ka gjëra për të cilat gazetarët nuk shkruajnë dhe nuk i përmendin, si për shembull emrin e plotë të një fëmije.

Ushtrim:

Merre një gazetë apo një revistë, dhe gjej fotografi ose tema të cilat mund të jenë kontraverze për disa njerëz, por jo për disa të tjerë. Për shembull, mund të gjeësh dy imazhe të cilat në raport me njëri tjetrin mund të përshkruhen si i mirë/i keq, ose i bukur/i shëmtuar, dhe mandej provo t'ua ndërrosh përshkrimet këtyre imazheve. A mund të shihet 'e

mira' si 'e keqe' dhe anasjelltas, varësisht se kush e sheh atë?

Tema të tjera diskutimi:

• Çfarë është çështje kontraverze në shoqërinë tonë? A mund të japësh disa shembuj?

• Pse është ndonjë çështje kontraverze në një vend dhe jo në vendet e tjera?

• Mendo se a mund të gjendet zgjidhje për çështjet kontraverze?

• Lexoje një gazetë dhe shih se a trajtohet aty ndonjë çështje kontraverze.

traverze. Nëse po, atëherë si trajtohet ajo? A mendon se gazeta ka shkruar në mënyrën e duhur për k'të çështje? Pse?

• Gjej rrëfime në gazetën tona të cilat mendon se nuk mund të gjenden në vende të tjera.

• Diskuto me shoqet dhe shokët e klasës se për cilat tema nuk mund të shkruani në gazetën e shkollës dhe pse.

• A do të kishe dashur të shkruash për një çështje kontraverze, dhe si do ta bëje këtë?

Teksti është përshtatur nga materiali i titulluar "Be controversial" në: www.worldpressfreedomday.org.

Falenderojmë WAN-IFRA - Shoqatën Botërore të Gazetave dhe Botuesve të Lajmeve që na lejoi shfrytëzimin e materialit.



Merri 3-4 gazeta të një dite dhe mendo për këto pyetje:

Si dallojnë faqet e para: cilat janë rrëfimet kryesore?
Si dallojnë fotot dhe ilustrimet, a janë ato të lidhura me ngjarjen?
Çka theksohet në artikull, cilat janë faktet që ofrohen?
A dominon një pikëpamje apo ka më shumë pikëpamje, dhe të kujt janë ato?
Cilat pjesë i ka gazeta (sporti, biznesi etj.) dhe sa hapësirë kanë këto pjesë?
Sa hapësirë kanë reklamat?
Si mendon, cila është gazeta më e mire, dhe pse?
Përsërite këtë ushtrim me radion dhe me televizionin!



Me folë haptazi, megjithatë, shpaguhet!

Jeta Xhara

Drejtoresh e BIRN (Balkan Investigative Reporting Network) në Kosovë

B.B. ishte një vajzë e re, e gjatë dhe e bukur. Kur para më shumë se gjashtë muajve hyri në zyren tonë askush nuk mendoi që ka me shpalos një storje aq të tmerrshme. Ajo kishte një vajzë të vogël dhe vitin e fundit, edhe pse ishte shkurorëzuar nga burri, ai e kishte rrahur disa herë - thjesht sa herë që ish-bashkëshorti e kishte taku në rrugë kishte bërë skena duke e rrah publikisht. B.B. e kishte raportuar atë në polici e gjykatë por asgjë s'ishte ndërmarrë. Pas vrasjes së Diana Kastratit që u vra nga ish-burri i saj, rast që e shokoi publikun kosovar, B.B. kishte vendos që nuk do ta mshel më gojën por do të flas haptaz për situatën e saj në media, pasi krejt mjetet tjera të raportimit të dhunës kishin dështu.

Ajo erdhi në emisionin "Drejtësia në Kosovë" dhe ne u ballafaquam me një përgjegjësi të madhe - nëse e përkrahim 'lirinë e saj të shprehjes' dhe e transmetojmë intervistën me të, ish-bashkëshorti do t'i kundërvihet. Çka nëse fjalët e saj lirshëm kanë me i kushtu me edhe ma shumë dajak se sa që ka marrë deri tash? Çka nëse kjo hakmarrje do të reflektohet edhe te vajza e vogël e kësaj viktime të dhunës familjare? Por në anën tjetër, si gazetarë ia shtonim edhe pyetjen tjetër vetvetes, nëse nuk flasim për këtë çështje a jemi edhe ne si krejt institu-

cionet tjera të cilat kur B.B. e ka raportu rastin, ato nuk kanë ndërmarrë asgjë? Vendosëm që në emisionin "Drejtësia në Kosovë" ta përcjellim këtë rast sistematikisht duke e intervistuar jo vetëm B.B.-në por të gjithë akterët të cilëve ajo u ishte drejtuar e që nuk kishin ndërmarrë asgjë. E thirrëm policinë dhe zyrtarët e mbrojtjes së viktimave nga dhuna familjare. E thirrëm prokuroren ku B.B. e kishte paraqitur rastin. E thirrëm gjykatësen ta pyesim se pse po vonohet seanca gjyqësore derisa viktimja jeton në ankthin e dajakut të mëtutjeshëm që mund ta hajë nga ish-burri? Nuk e transmetuam intervistën menjëherë por vazhduam t'i përcjellim seancat gjyqësore, të cilat filluan intensivisht pas thirrjeve tona nëpër institucione. Gjatë një seance e xhiruam prokuroren e shtetit e cila, përkundër faktit që e ka për detyrë ta mbrojë viktimën e jo të akuzuarin, ne e gjetëm

atë në korridor duke i shkëmbyer numrat me të akuzuarin, ish-burrin e dhunshëm të B.B. Këtë xhirim e transmetuam por nuk e lamë me kaq. Dërguam ankesë te Këshilli Disiplinor i Prokurorëve në Kosovë nga i cili kërkua të marrë masa kundër prokurores që i ka shkelur rregullat e punës. Pas një viti, ish-burri i B.B. i mbajti disa muaj burg dhe gjykimi për te vazhdon. Ndaj prokurores u ngritën hetime në bazë të ankesës së emisionit tonë i cili prezantoi fakte. Në fund prokurorja u dënua me 6 muaj heqje të 50% të pagës. B.B. e ka lëshu krejt Kosovën. Krejt kjo ndodhi pse një viktimitë morri guximin t'ju drejtohet mediave - vendosi me fol sh lirë, përkundër pasojave që do të mund t'i kishin ndodh. Para se me raportu mediati për këtë rast, dhunuesi nuk ishte futur në burg dhe institucionet nuk ishin marrë seriozisht me viktimitë dhe pafuqishme. Me folë haptazi, megjithatë, shpaguhet!



FALENDEROJMË WAN-IFRA - SHOQATËN BOTËRORE TË GAZETAVE DHE BOTUESVE TË LAJMEVE QË NA LEJOI SHFRYTËZIMIN E ILUSTRIMIT.

Sa të kushton identiteti?

A ke menduar ndonjëherë se sa vlen emri yt? Kuptohet, emri është identiteti ynë, është mënyra se si na njohin njerëzit. Kur njoftohemi me dike, ia tregojmë emrin, prezantohemi, për të treguar mirësjellje. Por, ka raste, sidomos në facebook, kur edhe mund të mos e tregojmë emrin. Në SHBA për shembull, në faqen <http://www.infousa.com/> mund të gesh informata për konsumatorë të ndryshëm, nëse jep një shumë të vogël parash. Një databazë që ka më se 210 milion përdorues, i shet të dhënat për një person ashtu siç shitet çdo mall tjetër. Pra emri dhe të dhënat e tua janë mall i shitjes për këtë kompani. Të dhënat janë mbledhur nga ueb-faqe të ndryshme, p.sh nga produktet që i ke blerë, apo të dhënat personale që i ke dhënë nëpër faqe. Emri yt pra mund të shitet, ashtu si shitet një CD apo një mollë. Çka mendon ti?

Zgjidhe një temë, dhe paramendo se je gazetar/e

Cilat elemente do t'i përfshish në artikull?
Kënd do ta intervistosh?
Cilat fakte do t'i kërkosh?
A të nevojiten të dhëna historike?
A do të përdorësh fotografi dhe ilustrime?

Ditari

Mbaje një ditar njëjavor për sasinë e kohës që e kalon me media. Sa herë që u ekspozohesh mesazheve mediatike në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbaj shënime në ditar.

Mesazhet e drejtpërdrejta janë ato të cilat i merr në kontakt të drejtpërdrejtë me një medium, p.sh. kur e sheh një episod të Kafeneja jonë. Apo kur dëgjon muzikë për gjysmë ore. Mesazhet e tërthorta janë ato që t'i përkujtojnë mesazhet e medieve, për sh. Kur e sheh në rrugë një reklamë të filmit, ti nuk e sheh filmin (që do të ishte mesazh i drejtpërdrejtë) por e sheh një porosi që ta përkujton filmin. Apo, kur flet me shoqërinë për Big Brother, ti nuk e sheh emisionin, por tërthorazi komunikon me të.

Në fund të javës përgjigju në këto pyetje:

Sa është sasia totale e kohës që kalon me media? Cili është raporti mes ekspozimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë? Cilat raste i ke nxitur vetë, në mënyrë aktive, dhe cilat kanë qenë pa iniciativën tënde? Cilat lloje të mesazheve kanë dominuar ?

Dijeta 24-orëshe pa asnjë media

Mos përdor asnjë mjet mediatik gjatë 24 orëve (përfshirë internetin dhe telefonin mobil). Përshtuaj përvojën dhe varësinë tënde nga mediat.

Llogarite kohën që e kalon me media gjatë një jave

Orët:

_____ leximi për kënaqësi
_____ leximi për shkollë
_____ leximi i gazetave dhe revistave
_____ dëgjimi i radios
_____ dëgjimi i muzikës së incizuar
_____ filmat në kinema
_____ emisionet televizive
_____ kompjuteri për punë
_____ kompjuteri për lojë
_____ kompjuteri si shoqërim
_____ Totali

A je e/i befasuar me rezultatin?

PUNUAN:

Prof. Lindita Tahiri me studentet e Masterit të Gazetarisë në UP: Blerta Aliu, Emira Bajcinca, Adelina Sahiti, Edlira Billaca.

Faqesja: Shkëmbim Krasniqi